



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2023:028338

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05448422

Nr. i lëndës në Ndërmjetësim 2012/2024

C.nr.54/2023

GJYKATA THEMLLORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.R., të cilët i përfaqëson me autorizim av. K.O. nga Mitrovica dhe e paditura Komuna Skenderaj - Drejtoria e Arsimit, me adresë në Rr."28 Nëntori", në Skenderaj të cilën e përfaqëson përfaqësuesi E.Ç. nga Skenderaj, për kompensim në pagë në bazë të rritjes së inflacionit, kompensim për ushqim gjatë punës dhe shpenzimet e udhëtimit, duke vendosur sipas marrëveshjes së palëve të arritura nga ndërmjetësuesi H.A. ndërmjetësuese e licencuar, bazuar në nenin 15 paragrafit 4 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe pas vlerësimit të marrëveshjes të dt.22.01.2024 të palëve të arritura në ndërmjetësim, me dt.13.03.2024, jep këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja e arritura në procedurën e ndërmjetësimit në lëndën C.nr.54/2023, me dt.22.01.2024.

II. Marrëveshja e arritura në ndërmjetësim e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

III. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse edhe kundër marrëveshjes së arritura, palët nuk kanë të drejtë ankese.

IV. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritura në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore.

Gjyqtari

Avdulla Mecinaj